



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 shtator 2020
Nr. Ref.:RK1621/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI119/19

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme APP-
UPP.nr.1/2018 të 26 shkurtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjytar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Nysret Beka, jurist.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme [APP-UPP.nr.1/2018] të 26 shkurtit 2019, të cilin e ka pranuar më 21 mars 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 21, paragrafi 4 dhe nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 korrik 2019, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese) Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 30 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe në pajtim me ligjin një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 23 tetor 2019, Gjykata në lidhje me parashtrimin e kërkesës njoftoi Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi në Pejë.
9. Më 23 tetor 2019, Gjykata, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, e kërkoi dosjen e plotë të lëndës.
10. Më 24 tetor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, ia dorëzoi Gjykatës dosjen e plotë të lëndës.

11. Më 31 nëntor 2019, lidhur me parashtrimin e kërkesës KI119/19 u njoftua edhe Vesna Drašković, drejtoreshë e shoqërisë aksionare SH.A. Izgradnja, Pejë (në tekstin e mëtejme: SH.A. Izgradnja, Pejë).
12. Më 27 nëntor 2019, avokati Teki Bokshi, përfaqësues i autorizuar i SH.A. Izgradnja, Pejë, dorëzoi komente në lidhje me kërkesën e AKP-së dhe kërkon që kërkesa e parashtrueses së kërkesës të refuzohet si e papranueshme.
13. Më 29 janar 2020, Gjykata nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DhPGJS) për çështje që lidhen me AKP-në, kërkoj informata të detajuara lidhur me procedurën (statusin) e lëndës SCC-10-0158, objektin e kërkuara me padi nga korporata Holding "EKOS" Sh.p.k. në lidhje me këtë kontest.
14. Më 5 shkurt 2020, DhPGJS, dorëzoi në Gjykatë informatat si ne vijim:
 - a. Kjo lëndë (SCC-10-0158) i referohet padisë së ushtruar nga ana e paditëses, Korporata Holding "Ekos" sh.p.k, me seli në Pejë.
 - b. Padia është parashtruar nga avokati B. M. nga Gjakova.
 - c. Paditësja me padi kërkon vërtetimin e statusit aksionar të Shoqërisë Aksionare "Izgradnja" dhe anulimin e Vendimit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit për shitjen-privatizimin e tenderit publik AKP 43 së Ndërmarrjes së Re "Iliri" shpk Pejë.
 - d. Me padi paditësja gjithashtu kërkoj lëshimin e masës së sigurisë mbi ndalimin e shitjes së ndërmarrjes së lartcekur (shih nen a).
 - e. Paditësja me petitutimin e kërkesëpadisë kërkon që të vërtetohet se ShA "Izgradnja" me seli në Pejë, nga e cila është themeluar Ndërmarrja e Re punëtorja "Iliri", shpk, nuk është ndërmarrje shoqërore por Sh.a. dhe si e tillë të konsiderohet jashtëjuridiksionit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
 - f. Me Aktvendimin e DHPGJS të datës 7 shtator 2010, kërkesa mbi lëshimin e masës së sigurisë është aprovuar, dhe AKP-ja është urdhëruar që të mos ndërmerr asnjë veprim për shitje të Ndërmarrjes së re, punëtorja "Iliri", shpk.
 - g. Me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS Aktvendimi i lartcekur (shih nen f) vërtetohet.
 - h. Veprimet procedurale, lidhur me padinë, konform ligjit për DHPGJS janë ndërmarrë.
 - i. çështja lidhur me padinë nuk ka përfunduar."
15. Më 10 qershor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Historiku

16. Ndërmarrja Sh.A. Izgradnja, Pejë ishte themeluar nga ish Fondi për zhvillim i Serbisë dhe shoqata aksionare "Ekos" në Pejë (ndërmarrje private), në bazë të kontratës me nr. 2487 dhe të nr.722, të 9 nëntorit 1992 për themelimin e ndërmarrjeve aksionare me kapital të përzier. Më 17 nëntor 1992, konform

kontratës së mësipërme, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me Aktvendimin nr.6285/92 ka bërë regjistrimin e Sh.A. Izgradnja, Pejë, me nr. identifikues Fi.nr.6285/1992.

Procedura administrative (jashtëgjyqësore)

17. Në një datë të paspecifikuar, SH.A. Izgradnja, Pejë, kishte paraqitur kërkesë për regjistrimin e paluajtshmërive me nr. 2243 dhe nr. 3168, ZK-Pejë në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, Komuna Pejë.
18. Më 8 qershor 2012, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, me Aktvendimin [nr.01/729-11], refuzoi si të pabazuar kërkesën e ndërmarrjes SH.A. Izgradnja, Pejë, për regjistrimin e pronave në pronësi të saj.
19. Më 29 qershor 2012, SH.A. Izgradnja, Pejë, parashtoi ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, kundër Aktvendimit [nr.01/729-11] të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Pejës.
20. Më 31 korrik 2012, Agjencia Kadastrale e Kosovës, me Aktvendim [AKK nr.03/313/12], refuzoi si të pabazuar ankesën e ndërmarrjes SH.A. Izgradnja, Pejë, dhe vërtetoi Aktvendimin [nr.01/729-11] të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, të Komunës së Pejës, të 8 qershorit 2012.

Procedura administrative (konflikti administrativ)

21. Në një datë të pasaktësuar, SH.A. Izgradnja, Pejë, paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nëpërmjet të cilës kërkoi anulimin e Aktvendimit [nr.01/729-11] të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Aktvendimit [nr.03/313/12] të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.
22. Më 13 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykim [AU.nr.986/2013], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e ushtruar nga SH.A. Izgradnja, Pejë, dhe vërtetoi Aktvendimin [nr.01/729-11] e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Aktvendimin [nr.03/313/12] e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.
23. SH.A. Izgradnja, Pejë, parashtoi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [AU.nr.986/2013] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 13 shtatorit 2013.
24. Më 9 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit, me Aktgjykim [AA.UZH.nr.352/2013], refuzoi si të pabazuar ankesën e SH.A. Izgradnja, Pejë, dhe vërtetoi Aktgjykimin [AU.nr.986/2013] e Gjykatës Themelore, të 13 shtatorit 2013.
25. SH.A. Izgradnja, Pejë, parashtoi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit [AU.nr.986/2013] të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Aktgjykimit [AA.UZH.nr.352/2013] të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit procedural.

26. Më 30 dhjetor 2015, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr.8/2015], aprovoi si të bazuar kërkesën e SH.A. Izgradnja, Pejë, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm; anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [AA.nr.325/2013] të 9 dhjetorit 2014 dhe Aktgjykimi [A.nr.968/2012 të 13 shtatorit 2013 dhe vendosi që lënda të kthehet në rivendosje, me arsyetimin:

“...Gjykata Supreme tani për tani nuk mund të pranojë një konkludim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët, se barra tatimore mund të jetë pengesë për tu regjistruar dhe për të bërë ndryshmin në operatin kadastral. Ky ndryshim nuk e përjashton detyrimin për të paguar tatimin nga ana e SHA 'Izgradnja'-Pejë, prandaj sipas mendimit të kësaj gjykate, ky ndryshim nuk mund të jetë shkak për refuzimin e kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve në operatin kadastral. (...). Duke pasur parasysh kontratën për themelimin e SHA 'Izgradnja' në Pejë me pronësi të përzier dhe regjistrimin e kryer te Gjykata Ekonomike në Prishtinë-Aktvendimi nr.6285/92 dt.17.11.92, Gjykata Supreme konsideron se, tani për tani, janë të papranueshme pikëpamjet juridike të gjykatave të instancave me të ulëta, të paraqitura në arsyetimet a aktgjykimeve të tyre, sepse sipas mendimit të kësaj Gjykate paditësi ka kërkuar që emërtimi i pronarit të bëhet në përputhje me ndërrimet e tij statusore dhe jo të kryhet ndërrimi i pronësisë. Kjo, për me tepër kur merret parasysh fakti se kërkesa për ndryshime në operatin kadastral është paraqitur me 22.03 1993. Arsyetimi i organeve administrative dhe i gjykatave të instancave me të ulëta se ne procedurën e zhvilluar sipas kërkesës së paditëses për ndryshime në operatin kadastral, nuk ka marrë pjese AKP-ja, sipas mendimit të kësaj Gjykate, nuk mund të jetë shkak për refuzimin e kërkesës së paditëse për ndryshimet në operatin kadastral, sidomos kur merret parasysh data e paraqitjes së I<kërkesës së parë për ndryshime (viti 1993) dhe fakti që organi administrativ i shkallës së parë ka mundur edhe vete të kërkojë nga kjo agjenci mendimin për ligjshmërinë e kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve në operatin kadastral. (...) Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme ka gjetur se tani për tani nuk mund të pranohet një konkludim i tillë juridik i Gjykatës së Apelit, dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti: administrativ, për shkak të aplikimit të gabueshëm të dispozitave të LKA-së, për të cilën arsye është dashur të anulohen aktgjykimet e gjykatave të instancës me të ulët. (...).”

Rishqyrtimit i procedurës administrative (konfliktit administrativ)

27. Më 8 shtator 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [A.nr.707/2016], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e ushtruar nga SH.A. Izgradnja, Pejë, duke lënë kështu në fuqi Aktvendimin [nr.01/729-11] e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Aktvendimin [nr.03/313/12] e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.
28. SH.A. Izgradnja, Pejë, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [A.nr.707/2016] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 8 shtatorit 2016, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit procedural.

29. Më 16 shkurt 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [A.UZH.nr.368/2016], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruar nga SH.A. Izgradnja, Pejë, dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [A.nr.707/2016] e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 8 shtatorit 2016.
30. Më 18 maj 2017, SH.A. Izgradnja, Pejë, në Gjykatën Supreme parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kundër Aktgjykimit [AA.UZH.nr.368/2016] të Gjykatës së Apelit, të 16 shkurti 2017 dhe Aktgjykimit [A.nr.707/2016] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 8 shtatorit 2016, për shkak të zbatimit të gabuar të të drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, me propozimin që Aktgjykimet e kontestuar të ndryshohen dhe kërkesëpadia e saj të aprovohet.
31. Më 10 maj 2018, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr.31/2017], aprovoi si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar nga e SH.A. Izgradnja, Pejë; ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [AA.UZH.nr.368/2016] të 16 shkurtit 2017 dhe Aktgjykimin [A.U.nr.707/2016], të 8 shtatorit 2016; anuloi Aktvendimin [nr.03/313/12] e Agjencisë Kadastrale të Kosovës të 31 korrikut 2012 dhe Aktvendimin [nr.01/729-11] e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, Pejë, të 8 qershorit 2012; dhe detyroi Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Pejë, që t'i regjistroje në operatin kadastral ndryshimet në paluajtshmëritë nr.2243 dhe nr.3168, zona kadastrale Pejë, nga ndërmarrja ndërtimore Izgradnja Pejë, në SH.A. Izgradnja, Pejë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Gjykata Supreme në këtë rast arsyetoi:

“Andaj, duke pasur parasysh edhe faktin se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë marrë fare për bazë udhëzimet të cilat ishin dhënë nga kjo Gjykatë në aktgjykimin ARIUZVP.nr.8/2015 dt.30.12.2015, me të cilin ishin prishur aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017 dhe aktgjykimi i Departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr. 707/2016 dt.08.09.2016, duke marrë në riprocedurë pothuajse aktgjykime identike dhe duke qenë se provat që ekzistojnë në shkresat e lëndës janë të mjaftueshme për të marrë një vendim meritore - Gjykata Supreme mori aktgjykimin me të cilin aprovoi si të bazuar kërkesën e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur kundër vendimeve të mësipërme të të dy gjykatave të instancës më të ulët, ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.368/2016 dt.16.02.2017 dhe aktgjykimin e Departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr. 707/2016 dt.08.09.2016 dhe anuloi aktvendimin e të paditurës AKK nr.03/313/12 dt.31.07.2012 dhe aktvendimin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Pejës nr.01/729-11 dt.08.06.2012, duke detyruar këtë Drejtori që në operatin kadastral të bëjë regjistrimin e ndryshimeve mbi paluajtshmëritë nr.2243 dhe 3168, zona kadastrale Pejë, prej Ndërmarrjes Shoqërore Ndërtimore "Izgradnja" nga Peja -në Sh.A. "Izgradnja" nga Peja, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.”

Kërkesa për rishikim të procedurës, respektivisht kërkesa për rishikimi të Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr.31/2017], të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2018

32. Më 7 nëntor 2018, parashtruesja e kërkesës në cilësinë e palës së interesuar në Gjykatën Supreme parashtroi kërkesë për rishikimin e Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr.31/2017] të Gjykatës Supreme të 10 majit 2018, duke pretenduar në shkelje të dispozitave të ligjit procedural dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet kërkesa e saj për rishikim, të prishet Aktgjykimi [ARJ-UZVP.nr.31/2017] i Gjykatës Supreme, dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.
33. Më 26 shkurt 2019, Gjykata Supreme me Aktvendimin e kontestuar [APP-UPP.nr.1/2018], e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për rishikim të Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr.31/2017], të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2018, me arsyetimin se kërkesa për rishikim është parashtruar nga një palë e paautorizuar, e cila nuk ka qenë pjesë e këtij kontesti, sepse palë paditëse në kontestin administrativ është SH.A Izgradnja, Pejë, dhe palë e paditur është Agjencia Kadastrale e Kosovës.
34. Më 6 qershor 2019, parashtruesja e kërkesës, kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kopjet e Aktgjykimeve të të gjitha instancave gjyqësore. Në shkresën e saj drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesja e kërkesës mes tjerash e kishte njoftuar Gjykatën Themelore se në DhPGJS është duke u zhvilluar një kontest, lidhur me statusin e SH.A. Izgradnja, Pejë.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

35. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme [APP-UPP.nr.1/2018] i 26 shkurtit 2019 është në kundërshtim me nenet: 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së.
36. Fillimisht, parashtruesja e kërkesës thekson: "Agjencia Kosovare e Privatizimit ("AKP") është organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e veta në mënyrë plotësisht autonome. E themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me ligjin Nr. 04/L-034, AKP është autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të tyre të përkufizuara në këtë ligj. Sipas ligjit për themelin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr 04/L-034), deri në transformimin e saj, AKP ka për obligim ligjor përfaqësimin, mbrojtjen dhe rritjen e vlerës, asetëve dhe pasurive në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë".
37. Në lidhje me çështjen kontestuese, parashtruesja thekson se: "AKP, më 11 tetor 2018, për herë të parë është njoftuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Bazuar në ligjin e AKP-së, Bordi i Drejtoreve në vitin 2009, ka përcaktuar se subjekti juridik-Ndërmarrja Shoqërore "Izgradnja" me seli në

Pejë, bie nën juridiksionin e AKP-së, në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për AKP-në”.

38. Në lidhje me Aktgjykimin e kontestuar parashtruesja e kërkesës shton: “AKP si përfaqësues ligjore e N.Sh. Izgradnja, konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale, duke vepruar në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë është i pa drejtë dhe i kundërligjshëm, prandaj kishte parashtruar kërkesën për rishikimin e këtij Aktgjykimi. Kërkesa është parashtruar në kuptim të nenit 55.1, paragrafi të 1.6 të ligjit mbi Konfliktet Administrative i cili ka përcaktuar se kush mund të parashtroj një kërkesë të këtillë dhe atë: "personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ”.
39. Tutje, parashtruesja e kërkesës pretendon se: “Vendimi i Gjykatës Supreme ka shkelur edhe dispozitat e ligjit, nenit të LKA, 39.1, është dashur të thirret në procedurë (në cilësinë e Personit të interesuar) ky nen ka përcaktuar se: "Gjyqtari Mbikëqyrës cakton ditën e shqyrtimit dhe në shqyrtim do të ftoje palët dhe personat e interesuar", dhe jo vetëm këtë nen, por edhe dispozitat e nenit 30.3, 37,1 etj.. të cilat kanë përcaktuar parimet procedurale dhe të drejtat e palëve në procedure si dhe obligimin e gjykatës për përfshirjen e palës me interes në procedurë si dhe ligjin për ATK, nenet 22, 32.1 dhe 33 të këtij ligji (Nr.3/L-222)”.
40. Parashtruesja e kërkesës konsideron se: “Gjykata Supreme e Kosovës me këtë Aktvendim ka cenuar rend ushtrimin e mandatit ligjore të AKP-së, duke shkelur të drejtën për përfaqësim ligjore të palës me interes për NSH Izgradnja me seli në Pejë, e ku objekt i këtij procesi ishin pronat e kësaj ndërmarrje”.
41. Parashtruesja e kërkesë në përfundim pretendon se: “Aktvendimi i Gjykatës Supreme është përcjellë me një mori shkeljesh ligjore dhe atë Ligjin për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/ L-034, Ligjin mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme Nr.04/L033, Ligjin e Procedurës Kontestimore Nr.03/L-006, Ligjin mbi themelimin e Administratës Tatimore të Kosovës Nr. 03/L-222, respektivisht nenet 32.1, 33.1 dhe nenin 22 të këtij Ligji. Parashtruesi thekson se “Si rezultat i këtyre shkeljeve ka ardhë deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale dhe Kushtetutën e Kosovës”.
42. Në fund parashtruesja e kërkesë kërkon nga Gjykata: “...të konstatojë shkeljet e cituara si në përshkrim të kësaj kërkesë dhe Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës APP-UPP. Nr. 1/2018, ta shpallë te pa vlefshëm si dhe të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP. Nr. 31/012 dhe rasti të kthehet në rigjykim”.

Dispozitat ligjore

Ligji Nr. 03/L-202 për Konflikt Administrativ

Neni 30

3. Bashkë me padi, paraqitet edhe nga një kopje e padisë dhe e dokumenteve të bashkëngjitura për organin e paditur dhe për çdo person të interesuar, nëse ekzistojnë të tillë.

Neni 37

1. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji, gjykata do t'ia dërgojë nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkëngjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar.

Neni 39

1. Gjyqtari Mbikëqyrës cakton ditën e shqyrtimit dhe në shqyrtim do të ftojë palët dhe personat interesuar.

Neni 55 Rishikimi

1. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur:

[...]

1.6. personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ.

Neni 58

Mbi kërkesën për rishikim vendos gjykata, që ka nxjerrë vendimin.

Neni 60

1. Mbi kërkesë për rishikim gjykata vendos në seancë të mbyllur.

2. Gjkata do ta hedhë poshtë kërkesën me vendim nëse vërteton se kërkesën e ka paraqitur personi i paautorizuar ose kërkesa nuk është bërë në kohën e duhur, apo pala nuk e ka bërë të paktën të besueshme ekzistimin e bazës ligjore për rishikim.

Pranueshmëria e kërkesës

43. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

44. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113 i Kushtetutës

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

Neni 21 i Kushtetutës
[Parimet e Përgjithshme]

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

45. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

46. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [APP-UPP.nr.1/2018] të 26 shkurtit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
47. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur gjithashtu kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin

39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, përkatësisht me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores, që përcaktojnë:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

48. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme me Aktvendimin e kontestuar [APP-UPP.nr.1/2018], të 26 shkurtit 2019, shkeli të drejtat e saj të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, sepse: *“..aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale, duke vepruar në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë është i pa drejtë dhe i kundërligjshëm, për arsye se, “personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ”.*
49. Në këtë kontekst dhe në vijim, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesë lidhur me (i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, dhe (ii) shkeljet e pretenduara të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së

50. Gjykata, duke marrë parasysh se esenca e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me gjykimin e drejtë dhe procesin e rregullt gjyqësor, rikujton përmbajtjen e dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, që përcaktojnë:

Neni 31 i Kushtetutës

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

Neni 6.1 i KEDNj-së

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në

sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë...”

51. Gjykata, vëren se pretendimet e parashtrueses së kërkesë për shkelje të nenit 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, ndërlidhen me mohimin e të drejtës së saj që në cilësinë e palës së interesuar të marrë pjesë në procedurën e konfliktit administrativ, që zhvillohej mes SH.A. Izgradnja, Pejë, (paditësja) dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës (e paditura), kontest i cili kishte të bënte me kërkesën e SH.A. Izgradnja, Pejë, për regjistrimin e paluajtshmërive të sipërcekura në emër të saj, në librat kadastral në Pejë.
52. Në këtë drejtim Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme [APP-UPP.nr.1/2018] të 26 shkurtit 2019, dhe vëren se Gjykata Supreme pretendimit të parashtruesit të kërkesës për mohimin e të drejtës që e njëjta të ftohej në cilësinë e palës së interesuar për të marrë pjesë në konfliktin administrativ të zhvilluar mes SH.A Izgradnja, Pejë, dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, kishte arsyetuar: *“Neni 58 i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton se për kërkesën për rishikim vendos gjykata, që ka nxjerrë vendimin ... ndërsa neni 60, paragrafi 2 i këtij ligji përcakton se Gjykata do ta hedhë poshtë kërkesën me vendim nëse vërteton se kërkesën e ka paraqitur personi i paautorizuar”*.
53. Tutje, Gjykata Supreme arsyetoi: *“Në çështjen konkrete juridike është zhvilluar konflikti administrative sipas padisë së paditësit SH.A.”Izgradnja” nga Peja, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, për anulimin e aktit administrative. Nga sa u tha më sipër, palët ndërgjyqëse në konfliktin administrativ janë SH.A.”Izgradnja dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës, prandaj te njëjtat kanë autorizim ekskluziv për të ushtruar mjete të rregullta dhe jashtëzakonshme juridike”*.
54. Në fund Gjykata Supreme, kishte konkludur: *“Sipas mendimit të kësaj gjykate, parashtruesi i kërkesës për rishikim, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk është palë në këtë konflikt administrativ dhe për këtë arsye nuk është personi i autorizuar për paraqitjen e kërkesës për rishikim, prandaj kjo gjykatë, nga të gjitha sa u tha më sipër, refuzoi si të palejuar kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për rishikim, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJUZVP.nr.31/2017 të datës 10.05.2018, duke pasur parasysh se kërkesa për rishikim, në pajtim me nenin 60, paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është paraqitur nga personi i paautorizuar”*.
55. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme nuk ia njohu parashtrueses së kërkesës legjitimitetin e palës së autorizuar, kësisoj e njëjta vendosi lënien në fuqi të Aktgjykimit të saj [ARJ.UZVP.nr.31/2017] të 10 majit 2018. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e kishte hedhur poshtë kërkesën e parashtrueses së kërkesës si “të palejuar” për shkaqe procedurale dhe pa shqyrtuar meritat e kërkesës. Gjykata Supreme, duke

interpretuar dispozitat e Ligjit për Konflikte Administrative erdhi në konkluzionin se kërkesa e parashtrueses së kërkesës për rishikimin e Aktgjykimit të vetë Gjykatës Supreme [ARJ.UZVP.nr.31/2017] të 10 majit 2018, duhej hedhur poshtë si e palejuar meqë kërkesa ishte parashtruar nga një palë e paautorizuar e cila nuk ishte pjesë e konfliktit administrativ që u zhvillua mes SH.A. Izgradnja, Pejë, dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

56. Andaj, siç mund të vërehet Gjykata Supreme, në baza procedurale të pranueshmërisë e hedhi poshtë kërkesën e parashtruar nga parashtruesja e kërkesës, nga arsyet e dhëna në Aktvendimin e kontestuar [APP-UPP.nr.1/2018] të 26 shkurtit 2019. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se nuk ka asgjë që tregon dhe provon se Gjykata Supreme me këtë rast ia shkeli parashtrueses së kërkesës të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, sepse Aktvendimi i Gjykatës Supreme është i qartë edhe sa i përket gjetjeve dhe konkludimeve përfundimtare.
57. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se: *“Vendimi i Gjykatës Supreme ka shkelur edhe dispozitat e ligjit, nenit të LKA, 39.1, ... edhe dispozitat e nenit 30.3, 37.1 etj.. të cilat kanë përcaktuar parimet procedurale dhe të drejtat e palëve në procedure si dhe obligimin e gjykatës për përfshirjen e palës me interes në procedurë si dhe ligjin për ATK, nenet 22, 32.1 dhe 33 të këtij ligji (Nr.3/L-222)”*.
58. Në kontekst të një pretendimi që ndërlidhet me interpretim të gabuar të ligjit të aplikueshëm, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. KIO6/17, parashtrues L.G. dhe pesë të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KIO122/16, parashtrues Riza Dembogaj, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; dhe rastin e Gjykatës KIO154/17 dhe KIO5/18, parashtrues të kërkesës, Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafi 60).
59. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin e GJEDNJ-së, García Ruiz kundër Spanjës, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 37; dhe KIO122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KIO154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 61).

60. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58 dhe KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 62).
61. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht e në rrethanat konkrete gjykatat, kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
62. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
63. Andaj, në këtë aspekt, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtrueses së kërkesës për shkelje të Kushtetutës, si rezultat i interpretimit ose aplikimit të gabuar të dispozitave të ligjeve relevante është qartazi i pabazuar, sepse nuk është përmbushur kushti i mësipërm, se në rastin konkret kemi të bëjmë me “*aplikim qartazi të gabuar të ligjit*” që do të qonte në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës.

Sa i përket pretendimeve të tjera për shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

64. Për me tepër, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar po ashtu shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në rastin konkret parashtruesja e kërkesës vetëm i përmend nenet respektive, por as me një fjalë të vetme nuk i arsyeton se si me Aktvendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese nga nenet 32 dhe 54, si dhe nga neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendimi për papranueshmëri, paragrafi 33; KI187/18 dhe KI 11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi* Aktvendimi për papranueshmëri i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, dhe se

fundmi rastin KI125/19 parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendimi për papranueshmëri i 11 marsit 2020, paragrafi 63).

65. Andaj, ne lidhje me këto pretendime, Gjykata ne përputhje me praktiken e saj kërkesën e parashtrueses së kërkesës e deklaroi qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme.

Përfundim

66. Si përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, përkitazi me pretendimet për shkelje të neneve: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrotjtja e Pronës] të KEDNj-së, në baza kushtetuese, duhet deklaruar qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 shtator 2020 njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci

Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi

